

Dübendorf, prill 2022

Të dashur prindër

Puna e fëmijëve dhe të rinjve të qytetit të Dübendorf-it (KJAD) si dhe specialistë të tjerë **IG Idee Jugend** trajtojnë temat «dhuna midis fëmijëve dhe të rinjve» dhe «vandalizmit».

Këto probleme janë shumë të pranishme në Dübendorf. Ndoshta ato tashmë kanë qenë temë bisede në shtëpinë tuaj.

Qyteti i Dübendorfit dhe **IG Idee Jugend** janë të shqetësuar se ka fëmijë dhe të rinj të dhunshëm që kërcënojnë të tjerët, sillen me mungesë respekti ndaj të tjerëve ose dëmtojnë gjëra. Ne jemi edhe më të shqetësuar për viktimat e këtyre fëmijëve dhe të rinjve të dhunshëm. Prandaj, IG Idea Jugend ka zhvilluar masa parandaluese për të luftuar këtë fenomen. Qëllimi është të promovohet guximi civil dhe të bëhen të njohura pikat e kontaktit dhe personat kontaktues.

Guximi civil do të thotë: Në një situatë të rrezikshme ose kur dikush kërcënohet, jo vetëm të shikosh nga ana tjetër, por të kesh guxim dhe të ngrihesh në mbrojtje të qenieve njerëzore.

Për të rritur ndërgjegjësimin e të gjithë popullatës do të ketë një fushatë posterash.

Në shkollat e mesme do të zhvillohen punëtori për nxënës dhe mësues. Në verë, KJAD organizon një festë për fëmijë dhe të rinj.

Qyteti i Dübendorfit dhe IG Idee Jugend janë të përkushtuar për një Dübendorf paqësor dhe të pastër!

Në faqen tonë të internetit [www.duebischauthin.ch](http://www.duebischauthin.ch) ose në fletushka do të gjeni oferta mbështetjeje dhe kontakte të personave kontaktues në Dübendorf.

Keni ndonjë pyetje ose shqetësim? Na kontaktoni. Ne jemi këtu për ju!

Përshëndetjet më të mira

## IG Idee Jugend



**IG Idee Jugend** ist eine Interessensgemeinschaft der Dübendorfer Jugendarbeit mit Personen aus: Kinder- und Jugendarbeit Dübendorf (KJAD), Beauftragte öffentlicher Raum, Schulsozialarbeit Primarschule, Schulsozialarbeit Sekundarschule, reformierte Jugendarbeit, katholische Jugendarbeit, kjz, KESB, Suchtpräventionsstelle und Gewaltpräventionsstelle Zürich Oberland, Kantonspolizei, Stadtpolizei.